

VENDIM
Nr.284, datë 6.4.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE “BESËLIDHJA”, BASHKIA LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja”, bashkia Lezhë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Lezhë.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 873 (tetëqind e shtatëdhjetë e tre) m² tokë truall, e vlerësuar me 20 000 (njëzet mijë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga bashkia Lezhë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit maj 2011.
 7. Bashkia Lezhë të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Bashkia Lezhë, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurive së paluajtshme që shpronësohen pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkia Lezhë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha